



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr _____ Prot

Vlorë, më _____. ____ 2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SEKTORI I PASTRIMIT, MIREMBAJTJE MJETESH”, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Bashkia Vlorë.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50100000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: **3,333,175 (tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2021, 2022 , 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur të kontratës. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar: **3,333,175x0.4=1,333,270 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e dyqind e shtatëdhjetë) lekë.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës

2.2.2 Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit (2021 - 2022 - 2023) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet qe te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet . Shenim: Ne respektojm te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nqs dy bilancet e njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

*** Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare ”.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.3 Vërtetim të shlyerjes së taksave e tarifave vendore për vitin 2024 në të gjitha adresat ku operatorët ekonomik kanë ushtruar aktivitetin e tyre sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKB-së.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

2.2.4 Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës (sipas nenit 83 të ligjit nr.162/2020 datë 23/12/2020) është 2% e fondit limit: **0.02x3,333,175= 66,663 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë.**

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël 20% e fondit limit, në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: **3,333,175x0.2 = 666,635** (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), me kodin : VII.3.B.1/a Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove;

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës nr.1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

2.3.3. Per te garantuar cilesine e punes gjate sherbimit,Operatoret ekonomik ofertues duhet te vertetojne se ka te punesuar **minimalisht 9 (nëntë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:**

1 drejtues Teknik me Dëshmi Aftësie Profesionale (DAP) te veprimtarisë se auto riparimit (referuar Ligjit Nr.9573, datë 03/07/2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” të ndryshuar, per riparimet dhe sherbimet qe do te kryhen),

Minimumi 1 inxhinier mekanik/mekatronik pasi keto jane mjete teknologjike me nje numer te larte paketash, sensoresh dhe këto profile inxhinierësh janë me të pershtatshem per keto lloj mjetesh,per te cilin duhet te paraqitet:

- 1- Diplome
- 2- Kontrate pune

Operatori ekonomik pjesemarrës duhet të ketë **personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës**: xhenerik, motorist, elektroaut, gomist, saldator, pompist, mekanik.

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik të me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- kontratat individuale të punës.
- Diplomë ose Çertifikatë kualifikimi në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional.

Operatori ekonomik duhet të dorëzoj listëpagesat për muajin prill 2024 - maj 2024- qershor 2024 në të cilën të figuroj stafi i lartëpërmendur.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërisë, të sistemeve drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj është e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut, bojaxhi e vertetuar kjo ne baze te kontratave te punës si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me sukses të kontrates. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar ne numrin e automjeteve qe kane nevojë per kryerjen e shërbimeve, si dhe natyren dhe numrin e shërbimeve qe kerkohen. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë ISO 9001 sipas objektit te kesaj kontrate (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e vlefshme te akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të

zgjdhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë ISO 14001 sipas objektit të kesaj kopntrate (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent të vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë .

AK rezervon mundesine e verifikimit të certifikatave pranë DPA në Ministrinë e Financave.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

Iso 14001 parashikon një sistem të menaxhimit të mjedisit sipas standarteve europiane, si në pjeset e kembimit që do të perdoren ashtu dhe në menyren e menaxhimit të shërbimit të mirembajtjes dhe riparimit të automjeteve të Autoritetit Kontraktor. Me anë të kesaj kerkese AK kerkon nga operatori ekonomik garanci në menaxhimin e mjedisit sipas standarteve nderkombetare të akredituara.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Ka të paktën një servis të specializuar për kryerjen e shërbimeve dhe riparimeve të mjeteve motorike, servis i cili duhet të ketë urrangritëse, nga të cilat të paktën një të jetë me peshë ngritese mbi 3,5 ton. Gjithashtu servisi duhet të disponojë dhe repartet e mëposhtme

- Repart xhenerik
- Repart motorik
- Repart elektroaut

Duhet të disponojë pajisjet dhe instrumentet e mëposhtme:

- -Gropë riparimi sipas standardeve teknike;
- -Elektrokompresor;
- -Pajisje për kontrollin e parametrave elektrik, të ndezjes dhe të sistemit të ushqimit;
- -Pajisje për kontrollin e presionit të fryrjes së gomave;
- -Pajisje për zmontimin dhe montimin e gomave;
- -Kompjuter për diagnostikimin e mjeteve;
- -Diagnostikues për kontrollin e parametrave të motorit;
- -Makinë për presim tubosh (në pronesi ose qera) për presimin e tubove hidraulike që do të riparohen;
- -Pajisje saldimi me hark elektrik dhe oksigjen për saldimin e pjesëve mekanike;
- -Minimumi 1 Torno për tornimin e spinotave, pistonave;
- -Minimumi 1 Bankoprovë për sistemet hidraulike: bankoprova shërben për testimin e tubove dhe pistonave hidraulike;

Per përmbushjen e këtij kriteri Operatori ekonomik duhet të ngarkojë në SPE fotot e pajisjeve të instaluar në servis.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve, te cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, ku një pjese e tyre mund të ofrohet nga OE duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht ambientin e prodhimit, makineritë, pajisjet, asetet e nevojshme të përcaktuara më sipër si dhe kapacitetet njerëzore, stafin e nevojshëm dhe kualifikimet profesionale me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të pakten 1 (nje) objekt për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve. (Ne pronesi ose me qera) Për të vërtetuar sa me sipër ofertuesi duhet të paraqesë:

1- Në rast se objekti është në pronesi duhet të paraqitet : certifikata e pronesisë.

2- Në rast se objekt është me qera duhet të paraqitet : kontrata e qerave dhe vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të objektit të prokurimit dhe shoqëruar me certifikatën e pronesisë.

2.3.8 Duhet të ketë Mjet transportues për transportin e mjeteve deri në servis pa pagesë, minimumi 1 (nje) copë (pronesi ose qera).

Për mjetin transportues (pronesi ose qera) për transportin e mjeteve duhet të paraqesë lejen e qarkullimit, kolaudimin, siguracionin, certifikatën e pronesisë ose kontratën e qerave nëse është me qera.

2.3.9 Në rastin e ndodhjes së servisit jashtë territorit ku ushtron aktivitetin Autoritetit Kontraktor NSHP BASHKIA VLORE, operatori ekonomik do të marrë përsipër të kryejë me shpenzimet e veta transportin vajtje – ardhje të automjeteve që kanë nevojë për shërbime,

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikime teknike, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së

*prokurimit. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **22/08/2024***